

Projekt – Zbatim për riparimin e infrastrukturës civile portuale

Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga

Infrastruktura rrugore ndodhet brenda territorit të Autoritetit Portual Durrës (APD).



Qëllimi i ndërhyrjeve të parashikuara:

Ndërhyrjet në infrastrukturën rrugore portuale kanë për qëllim riparimin e defekteve të infrastrukturës rrugore të APD-së. Këto ndërhyrje konsistojnë në riparimet e defekteve që pengojnë qarkullimin e mjeteve dhe rrisin rrezikshmërinë për përdoruesit e rrugës. Këto ndërhyrje nuk kanë qëllim kryesor rritjen e ndjeshme të jetëgjatësisë së rrugës apo rikthimin e saj në gjendjen fillestare pas ndërtimit.

Përshkrimi i lodhjeve/defekteve të rrugës

Defektet e krijuara në rrugë vijnë kryesisht nga trafiku i rënduar në infrastrukturën rrugore të APD-së, nga mosmirëmbajtja e rrugës në vitet e fundit, dhe nga lodhja. Defektet e rrugës mund të kategorizohen si:

Plasaritje të vogla:

Janë plasaritjet e shtresave sipërfaqësore të cilat nuk zhvillohen gjatë gjithë thellësisë së këtyre shtresave. Këto lloj plasaritjesh nuk krijojnë problem në qarkullimin e mjeteve dhe nuk janë objekt i kësaj procedure prokurimi. Plasaritjet mund të jenë gjatësore, tërthore, ose të kryqëzuara.



Çarje:

Konsiderohen plasaritjet e thella përgjatë gjithë thellësisë së shtresave sipërfaqësore mjaftueshëm të hapura sa të depërtojnë ujërat sipërfaqësor në shtresat e bazamentit dhe të ulin aftësinë mbajtëse të tyre. Çarjet mund të jenë gjatësore, tërthore, ose të kryqëzuara.



Çarje me valëzim ose barkim:

Konsiderohen plasaritjet e thella përgjatë gjithë thellësisë së shtresave sipërfaqësore mjaftueshëm të hapura sa të depërtojnë ujërat sipërfaqësor në shtresat e bazamentit, dëmtimi i të cilave ka sjellë valëzim apo barkim të shtresës së sipërfaqes.



Gropa në shtresat e asfaltit:

Dëmtim i shtresave asfaltike e cila mund të jetë përgjatë gjithë thellësisë së shtresave sipërfaqësore por pa çënuar shtresat e bazamentit, që kushtëzon shmangien e mjeteve nga trajektorja e lëvizjes dhe ul sigurinë në qarkullimin e mjeteve.



Gropa me prishje të shtresave të bazamentit:

Dëmtim i shtresave asfaltike e cila në të gjithë sipërfaqen ose pjesë të saj paraqet dëmtime dhe humbje të materialit të shtresave të bazamentit të rrugës, që kushtëzon shmangien e mjeteve nga trajektorja e lëvizjes dhe ul sigurinë në qarkullimin e mjeteve.



Plasaratije/Çarje në shtresat rigjide (beton)

Dëmtime lokale në blloqet e betonit në Terminalin e Makinave e cila pengon funksionimin normal të operacioneve në terminal dhe rrezikon dëmtimin e makinave gjatë nxjerrjes nga kontenierët



Ndërhyrjet e parashikuara

Në sipërfaqet ku ka çarje të mëdha me valëzime apo barkime të tapetit të asfaltobetonit do të pastrohet sipërfaqja duke përdorur kompresor ajri, dhe pasi sipërfaqja të jetë e pastër nga çdo lloj papastërtie do të sprucohet me emulsion bitumi dhe mbi shtresën e emulsionit do të vendoset mbishtresa e hollë e asfaltobetonit; Kur nga terreni për moskrijimin e sipërfaqeve shumë të holla asfaltobetonit apo disniveleve në rrugë sipas terrenit mund të nevojitet skarifikimi i pjesshëm i këtyre sipërfaqeve.

Në sipërfaqet ku tapeti i betonit ka çarje të mëdha, gropa (të cilat nuk arrijnë nivelin e shtresave granulare) do të hiqen shtresat asfaltike me sharrë asfaltobetonit dhe nëse shtresat granulare apo rigjide nën shtresa bituminoze paraqiten të padëmtuara atëherë do të vijohet me pastrimin e këtyre shtresave nga pluhurat/dherat dhe do të vijohet me spërkatje emulsionit bituminoz, shtresë binderi, shtresë asfaltobetonit.

Në sipërfaqet ku shtresat granulare si pasojë e mungesës së shtresave bituminoze kanë humbur ngjeshshmërinë do të pastrohet shtresa e pangjeshur dhe do të zëvendësohet me stabilizant, i cili në rast se gjerësia e ndërhyrjes nuk lejon ngjeshjen me rul të vogël do të ngjeshet me tokmak elektrik. Më pas do të vijohet me spërkatjen me emulsion bituminoz dhe shtresat e binderit dhe asfaltobetonit.

Korrigjimi i shtresave të bazës

Në sipërfaqet ku shtresat granulare si pasojë e mungesës së shtresave bituminoze kanë humbur ngjeshshmërinë do të pastrohet shtresa e pangjeshur dhe do të zëvendësohet me stabilizant ose do të korrigjohet me material bituminoz binder (pas pastrimit nga papastërtitë).

Pastrimi i sipërfaqeve

Para hedhjes së materialeve bituminoze, sipërfaqja do pastrohet dhe thahet për të eliminuar kështu gjithë materialet e rrezikshme.

Veshja apo shtresa e pare do thahet tërësisht para se të hidhet emulsionit bituminoz.

Sipërfaqja para hedhjes së emulsionit bituminoz duhet të jetë e pastër dhe pa papastërti dhe duhet të mbahet e tillë edhe pas hedhjes së emulsionit bituminoz deri në hedhjen e shtresave asfaltike.

Spërkatja me emulsion bituminoz

Pas pastrimit të sipërfaqëve të prera në mënyrë vertikale, dhe të fundit të gropave, pasohet me mbulose ngjitëse ose spërkatje me emulsion. Kontraktori duhet të bëjë kujdes në sigurimin e sasise se nevojshme të emulsionit që do përdoret..Kjo shtrese duhet të mbahet pastër dhe asfaltobetonit që do të përdoret duhet të hidhet 2-3 orë me vonë. Nëse shkaktohet ndonjë dëmtim nga kushtet atmosferike, ky dëmtim duhet të riparohet përpara shtrimit të asfaltit.

Mbusja e të çarave në shtresat e betonit

Shtresa e betonit përçark dëmtimeve duhet të hiqet me sharrë betoni në thellësi deri në 15 cm.

Sipërfaqja e përfutur e grupës duhet të trajtohet me material me rezinë për ngjitjen e betonit të ri me atë ekzistues apo me material ekuivalent. Betoni duhet të jetë me aditiv që ngurtësohet shpejt për të lejuar sa më shpejt rifillimin e operacioneve të ndërprera në terminal

Standardet që duhet të përmbushin materialet rrugore

Të gjitha materialet që sillen në vepër duhet të jenë në përputhje me V.K.M. nr. 628 datë 15.07.2015 "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve" ose standardeve EN.

Komentoi [u1]: Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 15.7.2015

Kontrolli dhe menaxhimi i trafikut gjatë ndërhyrjeve

Gjatë ndërhyrjeve përmirësuese duhet të krijohet zona e devijimit e sigurtë për përdoruesit e rrugës dhe punëtorët/pajisjet. Zona në afërsi të ndërhyrjeve duhet të kufizohet me trafik-ndarës. Trafik-ndarësit krijojnë ndarje fizike ndërmjet karrexhatave dhe në këtë mënyrë largojnë ndikimet e trafikut të kahut të kundërt, veçanërisht kur lihet hapësirë për ndërtimin e sistemit kufizues të automjeteve (SKM), nëse është e përshtatshme. Barrierrat e rrugore duhet të vendosen në zonën trafik ndarëse. Zona SKM duhet:

- të ofrojë distancën e shikimit për ngadalësimin/ndalimin e kërkuar;
- të pajset me sinjalistikë, në mënyrë të posaçme, për sigurimin e gjerësisë së duhur të punimeve dhe ngadalësimin për SKMs në varësi të setit të plotë të sinjalistikës;
- të rregullojë ndryshimet e konsiderueshme në nivelet e karrexhatave ngjitur;
- të rregullojë menaxhimin e konfigurimit të trafikut të përkohshëm gjatë çdo regjimi të mundshëm mirëmbajtjeje;
- të ofrojë hapësirë të mjaftueshme për aktivitetet e mirëmbajtjes;

Duhet të shmangët kudo ku është e mundur ndalimi i qarkullimit në më shumë se një korsë në distancë të tillë që të mundësojë qarkullimin e mjeteve. Aty ku është e nevojshme kontraktori do të vendosë punëtorë për orientimin e trafikut.

DOKUMENTACIONI TEKNIK

I gjithë materiali i projektit duhet të dorëzohet (në CD) në PDF versionet finale dhe në formatin origjinal të punuar, kompatibel me programet AutoCAD, Word, Excel brenda 21 ditësh nga data e lidhjes së kontratës dhe i dorëohet për miratim autoritetit kontaktor.

OE duhet të bëjë aplikimin për deklarate paraprake pranë institucioneve përkatëse brenda 5 ditëve nga marrja e miratimit nga autoriteti kontraktor.

Bazuar në llogaritjet edhe vizatimet e projektit, konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zerrat e punimeve që janë pjesë perberese të Listës Perfundimtare të Volumeve (Preventivit). Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe menyren e llogaritjes së tyre. Cmimet do të jenë sipas analizave teknike në fuqi. Zerrat e punimeve që nuk janë parashikuar në këtë listë cmimesh njësi të miratuar, konsulenti do t'i shoqërojë me analizen e llogaritjes së cmimit.

Zbatimi i projektit nuk mund të tejkaloj periudhën prej 6 javësh nga data e njoftimit të fillimit të punimeve.

Projekti me të gjitha raportet e kerkuara do të dorëzohet në formë të printuar në 5 (pesë) kopje në shqip të firmosura në origjinal dhe në formatet e kerkuar.

Garancia e punimeve, në vlerën prej 5% të preventivit, do të rikthehet operatorit ekonomik fitues 1 vit pas kolaudimit të punimeve.